

Të zbulojmë shkrimin së bashku

Shenjat e shkrimit dhe simbolet e magjepsin fëmijën tuaj. Me ndihmën tuaj ai mund të zbulojë sekretet e shkrimit në mënyrën e duhur. Letra dhe lapsat e ftojnë atë që të eksperimentojë.



Të frekuentojmë bibliotekën

Librat mund të bëhen shokë të ngushtë. Në bibliotekë ju së bashku me fëmijën tuaj mund të huazoni libra për në shtëpi dhe të huazoni media të tjera.



Të përdoren media të ndryshme

Përjetimet me të gjitha shqisat dhe aktiviteti jashtë janë pjesë përbërëse e përditshmërisë së fëmijëve sikurse shumëllojshmëria e mediave. Shoqërojeni fëmijën tuaj në zbulimin e tregimeve në libra, filma, libra dëgjimore dhe Apps.



Krijues në pikturim dhe shkrim

Vizatimi dhe pikturimi në letër, fotografimi i përbashkët dhe modelimi me smartphone dhe tablet e nxitin fëmijën tuaj që të shprehet nëpërmjet fotografisë dhe gjuhës



Të rritesh me përralla

Kështu e ndihmoni zhvillimin e gjuhës dhe leximit të fëmijës suaj në vitet e para të jetës.



SIKJM
ISJM
ISMR

Të flasësh në gjuhën amtare

Nëse ju flisni me fëmijën tuaj në atë gjuhë që ju e zotëroni më mirë, i jepni kështu atij një bazë të sigurtë për mësimin e gjuhëve të tjera.



Dëgjoni dhe jepni përgjigje

Fëmija juaj e zhvillon gjuhën e tij nëpërmjet bisedës me ju. Nëse ju flisni me të për vëzhgimet e tij, ai e zgjeron fjalorin e tij dhe kështu i lind dëshira për të zbuluar gjëra të reja.



Kënaqësia e përbashkët për gjuhën

Me gjuhën mund të luhet më së miri. Nëpërmjet vjershave, këngëve dhe lojërave me lëvizje fëmija juaj e përjeton atë në mënyrë shumë zbavitëse.



Të tregosh përralla dhe të shikosh figura

Tregimet dhe figurat i hapin fëmijës suaj botë të reja. Ai mund t'i eksplorojë ato së bashku me ju dhe të njohë shumë fjalë të reja.



Instituti zviceran për mediat për fëmijë dhe të rinj SIKJM/ISJM/ISMR

SIKJM/ISJM/ISMR angazhohet për letërsinë për fëmijë dhe të rinj. Ai zhvillon projekte që fëmijëve t'u zgjohet dëshira për letërsinë dhe për të lexuar dhe u tregon mësuesve dhe prindërve si t'i ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e gjuhës dhe leximit.

Në faqen e internetit të SIKJM/ISJM/ISMR gjeni **këshilla mediash** për të lexuar si edhe një **datbazë me vjersha dhe rima** në më shumë se njëzet gjuhë.

Në kuadrin e fillimit të leximit **Buchstart / Né pour lire / Nati per leggere** përfitoni një paketë me libra për beben tuaj dhe bibliotekat ju ftojnë të merrni pjesë në aktivitetet me përralla dhe vjersha me rima. Në Zvicrën gjermane dhe franceze mund të merrni pjesë në animacionet **Schenk mir eine Geschichte / 1001 histoires** për lexim në më shumë se njëzet gjuhë.

Informacione të mëtejshme:

www.sikjm.ch / www.isjm.ch / www.ismr.ch

**SIKJM
ISJM
ISMR**

Schweizerisches Institut
für Kinder- und Jugendmedien
Institut suisse
Jeunesse et Médias
Istituto svizzero
Media e Ragazzi